

Raporti vjetor 2016

Raporti vjetor i Institutit të Statistikave

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411 / +(355) 4
2233356
Fax+(355) 4 2228300

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë,
Shqipëri

info@instat.gov.al

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e shkurtimeve	3
HYRJE	4
Funksionimi i INSTAT	5
Objektivat strategjikë	8
Aktivitete kryesore për vitin 2016	9
Programi statistikor objektivat aktivitetet	12
Cilësia e të dhënave	14
Ngarkesa e të Intervistuarve	15
Anketa e kënaqësisë së punonjësve të INSTAT	19
Drejtoria e Llogarive Kombëtare	20
Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit	22
Drejtoria e Statistikave Ekonomike	24
Drejtoria e Statistikave Sociale	25
Burimet njerëzore dhe financiare	27
Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve	32
Publikimet - Databaza e kërkesave të përdoruesve	39
Publikimet – Të dhënat e faqes	42
Kontaktet e institucionit	44

Lista e shkurtimeve

AFP	Anketa e forcave të punës
AKP	Anketa e kostos së punës
ANR	Anketa e ndërmarrjeve të reja
ANJL	Anketa e njërive lokale
APC	Anketa post-census
ASN	Anketa strukturore e ndërmarrjeve
ATN	Anketa tremujore e ndërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
CAPI	Intervista me kompjuter
CATI	Intervista me telefon
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EDP	Procedura e Deficit të Tejkualuar
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Informacioni Gjeo-hapsinor
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IÇP	Indeksi i çmimeve të prodhimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti Mbështetës para Pranimit në BE
ISCO	Klasifikimi i Profesioneve
NVE	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NJEF	Njësi ekonomike familjare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SCB	Zyra e statistikave të Suedisë
SIDA	Agjencia Suedeve për Zhvillim

HYRJE

Të dashur lexues,

Viti që lamë pas ishte një vit inkurajues për Institutin e Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) i cili është prodhuesi kryesor dhe burimi më i madh i të dhënave statistikore zyrtare në Shqipëri.

Përmbushja e misionit të institucionit për të ofruar statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, ndihmon shumë përdorues, institucione publike, kërkues, akademikë, organizata ndërkombëtare dhe lokale si dhe individë të interesuar, për të pasur një pamje sa më afër realitetit ekonomiko-social në vend.

Besoj që INSTAT, duke u udhëhequr nga parimet e paanshmërisë, besueshmërisë, përkatësisë, përfitueshmërisë, konfidencialitetit si dhe transparencës ka arritur të ofrojë të dhëna të besueshme duke rritur cilësinë statistikore.

Ne u angazhuam për të rritur efikasitetin e institucionit tonë duke riorganizuar punën e veprimeve statistikore. Ne jemi në rrugën për zbatimin e metodologjive më të reja dhe arritjen e objektivave të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare.

Ne jemi krenar për stafin dhe punën e tyre, e cila reflektohet në besueshmërinë e përdoruesëve mbi të dhënat që INSTAT publikon. Puna për rritjen e kapaciteteve asnjëherë nuk mbaron dhe ne jemi të vendosur në misionin tonë për të rritur cilësi statistikore.

Ky raport do t'ju jap një pamje të të gjithë aktiviteteve statistikore dhe performancës së institucionit. Rezultatet janë inkurajuese.



Delina IBRAHIMAJ
Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT

Funksionimi i INSTAT

Misioni i INSTAT

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni i INSTAT

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikor.

INSTAT, si burimi kryesor i informacionit statistikor, u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje dhe kërkime, duke shpërndarë informacionin statistikor në të njëjtën kohë për të gjithë grupet e përdoruesve.

Gjithashtu, INSTAT ndihmon edhe komunitetin ndërkombëtar të interesuar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor të sigurt dhe të krahasueshëm.

Legjislacioni

Veprimtaria e INSTAT rregullohet me Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004 "PËR STATISTIKAT ZYRTARE", ndryshuar me: Ligjin nr. 21/2012 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare"; dhe me Ligjin nr. 7/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar".

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor i të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes

ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj si dhe në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice)¹.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të përbashkët të cilësisë së Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) dhe synon të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane.

Organizimi dhe zbatimi i programit statistikor kombëtar udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) "paanshmëria", që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;
- b) "besueshmëria", që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kritereve shkencore për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;
- c) "pavarësia profesionale", që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore,

¹ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;


ç) "përkatësia", që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar;

d) "kosto-efektiviteti", që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar;

dh) "konfidencialiteti statistikor", që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) "transparenca", që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Organigrama e INSTAT



Objektivat strategjikë

INSTAT mbështetur në objektivat e PSZ 2012-2016, gjatë vitit 2016 ka punuar për të realizuar:

1. Prodhimin e statistikave sa më cilësore, të kuptueshme dhe të besueshme për përdoruesit, duke e shoqëruar çdo statistikë me prodhimin e treguesve të cilësisë dhe hartimin e raportit të cilësisë. Ndërtimi i metadatave për çdo aktivitet statistikor në formë standarde dhe publikimi i tyre në faqen e web të INSTAT.
2. Ofrimin tek përdoruesit të treguesve të rinj dhe produkteve të reja statistikore, përmirësimi i treguesve ekzistues dhe respektimi i afateve kohore, do të jenë disa prej orientimeve kryesore për vitin në vazhdim.
3. Përmirësimin e teknikave të grumbullimit të informacionit statistikor duke përdorur metoda moderne si CAPI të cilat shkurtojnë kohën e kapjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe do të përmirësojnë afatet e publikimit të tyre.
4. Respektimin e afateve të përcaktuara në kalendarin e botimeve të publikuar në faqen e INSTAT: www.instat.gov.al.

Aktivitete kryesore për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 INSTAT është angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Programit Kombëtar Statistikor 2012-2016. Ndër aktivitetet kryesore të tij kanë qenë:

Produktet mujore :

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (Dhjetor 2015 – Nëntor 2016)
2. Tregtia e Jashtme (Dhjetor 2015 – Nëntor 2016)

Produktet tremujore:

1. Tregtia me Pakicë
2. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
3. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (Për Banesa)
4. Statistikat Afatshkurtra
5. Anketa tremujore e forcave të punës
6. Vlera e Shtuar Bruto

Produkte gjashtëmujore:

1. Bilanci i Energjisë Elektrike Gjashtëmujori, I - 2016

Produkte Vjetore:

1. Produkti i Brendshëm Bruto, Paraprak 2015, gjysmë final 2014 dhe final 2013
2. Produkti i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike, 2014.
3. Tabelat Burim-Përdorime, 2013

Gjatë vitit 2016 është realizuar përgatitja e publikimeve në përputhje me rregulloren e miratuar të botimeve, kryesisht të botimeve në format libër.

- Buletini Statistikor (T4-2015, T1-2016, T2-2016, T3-2016)
- Femra dhe Meshkuj, 2015
- Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2014
- Tregu i Punës, 2015
- Regjistri i Ndërmarrjeve, 2015
- Shqipëria në Shifra, 2015
- Shqipëria në Shifra, 2015 (anglisht)
- Ecuria e Tregtisë së Jashtme, 2015
- Vjetari Statistikor 2011-2015
- Vjetari Statistikor 2011-2015 (anglisht)
- Tregtia e Jashtme e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2011- 2015
- Vjetari Statistikor Rajonal, 2016
- Vjetari Statistikor Rajonal, 2016 (anglisht)

Aktivitete

Gjatë vitit 2016, janë organizuar dhe publikuar aktivitetet e mëposhtme, të cilat janë shoqëruar me materialet, si njoftime për media, prezantime, publikime, materiale të tjera si dhe foto.

1. Më datë 7 Dhjetor 2016, INSTAT në bashkëpunim me Bankën Botërore prezantoi studimin "Një profil i varfërisë dhe pabarazisë në Shqipëri"
2. Më datë 3 Dhjetor 2016, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për Statistikat Makroekonomike dhe Financiare ndërmjet INSTAT, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.
3. Më datë 24 Nëntor 2016, INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizuan seminarin "Puna përgatitore e INSTAT për zbatimin e standardeve të reja ndërkombëtare të statistikave të punës-zënies, punësimit dhe nën-përdorimit të punës"
4. Gjatë datave 14 - 17 Nëntor, INSTAT priti misionin nga EUROSTAT, me përfaqësues Desk officer për Shqipërinë Z. Torbioern Carlquist. Gjatë këtyre ditëve u realizuan një

sërë takimesh mes Menaxhimit të lartë dhe stafit të INSTAT për tu përditësuar me të rejat më të fundit.

5. Gjatë datave 5-7 Shtator, INSTAT priti misionin e përvitshëm nga EUROSTAT, ku morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Marrëdhënieve me Jashtë të Eurostat Z. Pieter Everaers dhe Desk officer për Shqipërinë Z. Torbioern Carlquits. Gjatë këtyre ditëve u realizuan një sërë takimesh mes stafit të INSTAT, Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë, Takim me Përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit dhe Delegacionin Europian.
6. Më datë 20 Prill u organizua workshopi teknik me tematikë "UNICEF mbështet INSTAT për hartimin e Programit të ri Kombëtar Statistikor Zyrtar". Qëllimi i këtij aktiviteti ishte për të informuar dhe të konsultuar mbi procesin e hartimit të Programit Kombëtar të Statistikave, të theksojnë rëndësinë e ndërveprimit midis institucioneve për të ndërtuar një program statistikor gjithëpërfshirës.
7. Më datë 31 Mars 2016, u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimi në fushën e statistikave, ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Bujqësisë.

Programi statistikor objektivat aktivitetet

INSTAT ka bërë përpjekje të përbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga PSZ aktuale 2012-2016. Nga aktivitete statistikore të parashikuara në PSZ për vitin 2016, aktivitetet e porealizuara janë si më poshtë:

Tabela 1: Lista e aktiviteteve të porealizuara apo jo të përputhura plotësisht me standartet e Eurostatit, për vitin 2016

Nr	Aktivitete	Situata
1	Shkaqet e vdekjeve sipas skedës për vdekjet mbi dhe nën një vjeç	Pa realizuar
2	Lista e produkteve (Lista e produkteve të Komunitetit PRODCOM)	Disponohet në nivelin 6 shifror dhe jo 8 shifror sipas kërkesave të Eurostatit
3	Treguesit e kërkim zhvillimit dhe Inovacionit në ndërmarrjet ekonomike	Mungesë ekspertize
4	Publikimi i Llogarisë së Prodhimit dhe Llogarisë së të Ardhurave sipas sektorëve Institucional	Pa realizuar
5	Vrojtimi vjetor në Bujqësi	Treguesit janë përlogaritur bazuar në të dhënat administrative

Shkaqet e mosrealizimit

Shkaqet në mosrealizimin e aktiviteteve janë të lidhura edhe me institucione të tjera apo në situatën konkrete të mosplotësimit të kushteve, në nivel vendi.

- Me gjithë përpjekjet e INSTAT për të realizuar aktivitetin mbi “shkaqet e vdekjeve”, deri tani ka qenë i pamundur sigurimi i informacionit të plotë mbi këto shkaqe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- Përsa i përket “Listës PRODCOM”, Shqipëria akoma nuk i plotëson tërësisht kriteret e hartimit të kësaj liste deri në 8 shifrore konform standarteve evropiane. Kjo liste disponohet në nivel 6 shifror.

3. INSTAT ka organizuar dy vrojtme statistikore pranë ndërmarrjeve ekonomike, mbi Kërkim zhvillimin dhe Inovacionin. Përpunimi i të dhënave të grumbulluara kërkon asistencë teknike të veçantë, e cila është ofruar në vitin 2017.
4. Mungesa e regjistrit të fermave apo regjistrave të tjerë administrativë (përfshirë Censusin e Bujqësisë), nuk ka mundësuar zbatimin e metodologjive ndërkombëtare për realizimin e vrojtmeve statistikore për sektorin bujqësor. Megjithatë disa nga treguesit janë përlogaritur bazuar në të dhënat administrative.

Cilësia e të dhënave

Sigurimi i cilësisë është i rëndësishëm për çdo aktivitet dhe për çdo fazë operacionale të proceseve statistikore. INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e rëndësisë, saktësisë, të kohës, përpikërisë, e drejta e hyrjes, qartësisë, të krahasueshmërisë dhe koherencës. Në kryerjen e detyrave, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice).

Gjatë vitit 2016, INSTAT implementoi standardet e raportit të cilësisë, bazuar në Sistemin Statistikor European. Këto standarde përcaktojnë ESMS (Euro SDMX Metadata Structure): raportin e cilësisë për përdoruesit dhe ESQRS (ESS Standard Quality Report Structure): raportin e cilësisë për prodhuesit e statistikave. Përpilimi i një dokumenti standard për menaxhimin e cilësisë, shihet si një mundësi dhe si sfidë e së ardhmes, i cili do të përshkruajë rregullat e brendshme dhe kontrollet e cilësisë për të gjitha hapat e proceseve statistikore.

Cilësia e regjistrave

Burimi kryesor për mirëmbajtjen e regjistrit statistikor të ndërmarrjeve është regjistri i bizneseve. Gjatë vitit 2016 u përgatit raporti Shqip dhe Anglisht për raportimin e cilësisë për përdoruesit sipas modelit ESMS. Ky raport pritet të publikohet për përdoruesit në publikimin e ardhshëm të të dhënave të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve.

Cilësia e të dhënave në anketa

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2016, kanë si bazë zgjedhje rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2016, kanë si bazë zgjedhje Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve 2015. Faqja e internetit të INSTAT përfshin informacione konceptuale dhe metodologjike për çdo temë statistikore, duke ndihmuar përdoruesit për të kuptuar dhe vlerësuar cilësinë e statistikave.

Ngarkesa e të Intervistuarve


Statistikat ekonomike përdorin vetëm një tregues për të vlerësuar numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet sipas madhësisë, duhet të përgjigjen (Response burden). Për të arritur një shpërndarje të barabartë të “response burden” për kryerjen e vrojtimeve merret në studim një kampion i zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve. Kampionet e vrojtimeve të kryera nuk janë të koordinuara me njëra tjetrën, por lista e ndërmarrjeve me mbi 10 të punësuar vrojtohet rregullisht në çdo anketë sipas aktiviteteve që mbulon anketa. Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2016, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimit pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1-9 të punësuar	130.296	13.660	498	188
10-19 të punësuar	456	2.576	465	122
20-49 të punësuar	464	1.177	629	105
50+ të punësuar	457	231	526	438

Në vitin 2016, janë anketuar rreth 13,5 % e ndërmarrjeve nga 152.288 të regjistruara në vitin 2015. Janë intervistuar gjithsej 20.615 ndërmarrje, nga të cilat 85,6 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 14,4 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë ndërmarrjeve gjatë vitit 2016.

Figura 1: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes



Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 90,1 %, nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 9,4 % kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (më pak se 1 %) ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 69,1 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 5 pyetësorë për t'u përgjigjur dhe vetëm 30,9 % e tyre ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart ku rreth 72,3 % e tyre duhet t'u përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Statistikat pranë familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar “Ngarkesën e të intervistuarve”: Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t'u përgjigjur dhe kohëzgjatjen e intervistës. Gjatë vitit 2016 INSTAT ka realizuar 6 anketa pranë familjeve.

Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2016 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2016,


janë anketuar rreth 5,6 % Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Census. Janë intervistuar gjithsej 40.804 NJEF, nga të cilat 98,2 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 1,8 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë familjeve gjatë vitit 2016. Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve për vitin 2016, duke marrë në konsideratë të gjitha vrojtimet pranë familjeve që realizon INSTAT, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve

Qarku	Asnjë vrojtim	Një vrojtim	Dy vrojtime	Numri i NjEF për Qark
BERAT	36.265	2.166	62	38.493
DIBËR	27.757	1.768	48	29.573
DURRËS	62.888	3.708	55	66.651
ELBASAN	68.702	4.263	79	73.044
FIER	77.401	4.591	109	82.101
GJIROKASTËR	19.665	1.576	20	21.261
KORÇË	56.400	3.684	87	60.171
KUKËS	15.941	1.169	16	17.126
LEZHË	30.210	1.994	33	32.237
SHKODËR	51.019	3.338	70	54.427
TIRANË	187.141	8.975	101	196.217
VLORË	48.069	2.830	62	50.961
GJITHSEJ	681.458	40.062	742	722.262


Gjatë vitit 2016, në qarkun e Beratit janë intervistuar gjithsej 2,228 NJEF, nga të cilat 97,2 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 2,8 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 vrojtime të realizuara nga INSTAT.

Figura 2: Ngarkesa e përgjigjes për NJEF që janë përzgjedhur për t'u intervistuar të paktën një herë, në përqindje



Kohëzgjatja mesatare e intervistës për disa nga anketat pranë familjeve në vitin 2016 jepet në figurën e mëposhtme.

Figura 3: Kohëzgjatja e intervistës mesatare/ NJEF



Kohëzgjatja e intervistës mesatare për familje, për Anketën e Forcave të Punës është rreth 21 minuta, për Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës është rreth 76 minuta dhe për Anketën e Buxhetit të Familjes është rreth 44 minuta.

Anketa e kënaqësisë së punonjësve të INSTAT

INSTAT për herë të parë realizoi gjatë vitit 2016, Anketën e Kënaqësisë së Punonjësve. Kjo anketë ka si objekt kryesor analizimin e qëndrimeve dhe perceptimeve të stafit të INSTAT si dhe identifikimin e çështjeve të cilat kërkojnë vëmendje për t'u zgjidhur në vitet në vazhdim. Cilësia e statistikave zyrtare të prodhuara apo kënaqësia e përdoruesve të INSTAT, lidhet drejtpërdrejtë me motivimin dhe profesionalizmin e punonjësve. INSTAT kujdeset për kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe kompetencave të tyre. Çdo institut statistike duhet të masë vlerësimin/perceptimin e punonjësve rreth çështjeve të mësipërme.

Modeli për krijimin e indikatorit të nivelit të kënaqësisë së punonjësve është ndërtuar sipas American Customer Satisfaction Index (ACSI) dhe merr në konsideratë këto faktorë: Ambientet e Punës, Natyrën e Punës, Marrëdhënien me Koleget, Marrëdhënien me Eprorët, Informimin mbi ngjarjet e ndryshme, Perceptimin e Imazhit. Avantazhi i përdorimit të ACSI është se ky model është i përshtatur për të matur nivelin e kënaqësisë në sektorin publik.

Shkalla e përgjigjes, e llogaritur si raport i numrit të punonjësve që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të punonjësve që ka aktualisht INSTAT, shprehur në përqindje rezultoi 86,3 për qind.

Niveli i kënaqësisë së punonjësve në INSTAT është mesatarisht rreth 3,53 ose i shprehur në përqindje rreth 70,6 %. Ky indikator është matur në shkallën nga 1 deri në 5. Niveli i kënaqësisë së punonjësve sipas grupmoshës është më i lartë për punonjësit mbi 50 vjeç, ndërsa punonjësit nga 30-49 vjeç janë punonjësit më të pakënaqur.

Punonjësit e INSTAT janë më të kënaqur lidhur me marrëdhëniet me eprorët, natyrën e punës si dhe perceptimin e imazhit.

Punonjësit e INSTAT kanë shprehur vlerësim pozitiv për punën që kryejnë. Pothuajse të gjithë punonjësit, rreth 90,65 % , mendojnë se paga e tyre nuk është e përshtatshme për punën që ata realizojnë.

Drejtoria e Llogarive Kombëtare

Drejtoria e Llogarive Kombëtare është drejtoria kryesore e prodhimit të statistikave makroekonomike, duke ofruar informacion mbi situatën ekonomike të gjithë përdoruesve të këtyre statistikave, si: institucionet publike, rrethet e kërkuesve dhe akademikëve, organizatat ndërkombëtare dhe lokale si dhe individë të interesuar për qëllimet e tyre.

Baza metodike e të dhënave synohet të jetë e harmonizuar rregulloren më të fundit të Bashkimit Evropian, atë të Sistemit Evropian të Llogarive 2010 (ESA 2010), i cili është version evropian i Sistemit të Llogarive Kombëtare në nivel botëror (SNA-2008).

Aktivitetet e vazhdueshme të realizuara:

Bazuar në planin e aktiviteteve për vitin 2016, si dhe në përputhje me PSZ 2012 – 2016, Drejtoria e Llogarive Kombëtare (DLLK) ka vazhduar punën për realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

1. Llogaritja e PBB-s finale 2013, gjysëm-finale 2014 dhe paraprake 2015, sipas 2 metodave kryesore, asaj të Prodhimit dhe të Shpenzimeve;
2. Vlerësimi i treguesit të të Ardhurave Kombëtare Bruto;
3. Publikimi i statistikave Rajonale, sipas klasifikimit NUTS 2 / 3;
4. Prodhimin dhe publikimin e treguesve tremujorë me metodën e Prodhimit dhe të Shpenzimeve për: Tr4-2015, Tr1-2016, Tr2-2016, Tr3-2016 (publikuar në 12 Janar 2017);
5. Përpilimi i tabelave Burime-Përdorime (TBP) për vitin 2013 me çmime korente në nivel detajimi 89 aktivitete * 89 produkte dhe në nivele më të agreguar 65 * 65 dhe 35 * 35, sipas nomenklaturave NVE Rev 2 për industrinë dhe CPA 2008 për produktet. Publikimi i tabelave u bë në nivelin 35 * 35 për të qënë në një linjë me treguesit e tjerë të LLK;
6. Përpilimi i tabelës Input – Output (TIO) për vitin 2013, tabelë e derivuar nga tabela Burime-Përdorime dhe publikimi i TIO në nivel 35 *35;

7. Përmirësime metodologjike dhe kryerja e vlerësimeve në kuadër të projektit IPA 2014. Gjatë vitit 2016, DLLK është asistuar vetëm nga projekti IPA 2014 MB, me 4 projekt-pilote:
 - *PP1: Metodologjia e Llogarive Kombëtare*
 - *PP2: Transmetimi i ESA 2010 dhe Llogaritë kombëtare tre-mujore*
 - *PP3: Statistikat Financiare të Qeverisë*
 - *PP20: (MIP) – Procedura e Imbalancës Makroekonomike*
8. Hartimi i PSZ 2017-2021;
9. Hartimi dhe firmosja e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë për “Statistikat Makroekonomike dhe Financiare”;

Aktivitetet e reja të realizuara:

1. U realizua rishikimi i serisë kohore 1996-2008 të PBB me të dyja metodat, për implementimin e ESA2010 dhe NVE Rev 2. Të dhënat u dërguan në EUROSTAT me SDMX sipas kërkesave të programit të transmetimit ESA 2010.
2. Vlerësimi në formë eksperimentale e llogarive jo-financiare në nivel tremujor për 2008_Q1-2016Q3, duke i klasifikuar rezultatet edhe sipas NACE Rev2. Ky ishte tentativa e parë e SLLKAPQR për të ndërtuar një sistem tremujor/vjetor sa më të plotë.
3. Ushtrim i parë për përpilimin e tabelave Burime- Përdorime me çmime konstante, për vitin 2013, në nivel detajimi 89 * 89 dhe në nivele më të agreguar 65 * 65 dhe 35 * 35, sipas nomenklaturave NVE Rev 2 për industrinë dhe CPA 2008 për produktet. Ndërtimi i sistemit dhe vlerësimi të parë të tabelave me çmime konstante u bë nën asistencën e projektit IPA PP1. Rezultatet nuk u publikuan pasi është në fazë konsolidimi.
4. Janë vlerësuar në formë eksperimentale, dy llogaritë e para, llogaria e Prodhimit dhe llogaria e Gjenerimit të të ardhurave sipas sektorëve institucional. Rezultatet nuk u publikuan pasi janë në fazë konsolidimi.

Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) përcakton, harton, përpunon dhe prodhon të gjithë treguesit statistikorë të sektorit bujqësorë dhe mjedisor të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare (PSZ) dhe në Planin Vjetor të Punës të Institutit të Statistikave të tilla si: statistikave të tokës, prodhimit bimor dhe pyjet, llogaritve ekonomike në bujqësi dhe mjedis dhe statistikave të blegtorisë, peshkimit dhe mjedisit.

Këto tregues janë të rëndësishëm për hartimin e politikave të përbashkëta bujqësore, mjedisore si dhe monitorimin e tregut bujqësor por gjithashtu dhe për menaxhimin e këtyre fushave.

Aktivitetet e vazhdueshme të realizuara:

- Anketa mujore për mbledhjen e çmimeve të produkteve bujqësore
- Anketa tremujore për mbledhjen e çmimeve të input-eve në bujqësi
- Anketa tremujore e çmimeve për kafshët e fermës peshë e gjallë (për mbarësim)
- Vrojtimi Vjetor i Qumështit dhe Nënprodukteve të tij
- Të dhëna administrative mbledhur nga MBZHRAU
- Të dhëna administrative të cilat merren nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit për Pyjet, Kullotat, Biodiversitetin dhe Mjedisin
- Vrojtimi mujor për qumështin dhe nënproduktet e tij (vetëm për qumështin e lopës)
- Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta
- Vrojtimi mujor mbi monitorimin e i aktivitetit të thertoreve të shpendëve
- Vrojtimi mujor në fermat e pularive që prodhojnë vezë për treg
- Vrojtimi mbi mbetjet e ngurta urbane
- Vrojtimi mbi prodhimin e energjisë nëpërmjet përdorimit të lëndës drusore është një aktivitet i pa planifikuar të cilin INSTAT në bashkëpunim me FAO-n realizuan përgjatë vitit 2016

Aktivitetet e reja të realizuara:

- Kalibrimi i Censurit të Bujqësisë përgjatë vitit 2016 u punua për ndërtimin e pyetësorit si dhe metodologjisë përkatëse për të realizuar implementimin në terren

- Vrojtimin Vjetor në Bujqësi në vitin 2016 është punuar në lidhje me hartimin e pyetësorit dhe manualit të anketuesve
- Vrojtimi pilot lidhur me mbetjet industriale
- Vrojtimi pilot lidhur me përdorimin e ujit

Drejtoria e Statistikave Ekonomike

Drejtoria e Statistikave Ekonomike (DSE) përcakton, harton, përpunon dhe prodhon të gjithë treguesit statistikorë të ndërmarrjeve, shkëmbimit të mallrave dhe çmimeve të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare (PSZ) 2012-2016, dhe në Planin Vjetor të Punës të Institutit të Statistikave.

Aktivite të vazhdueshme të realizuara:

1. Llogaritja dhe publikimi me periodicitet mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK);
2. Kryerja e vrojtimeve dhe dërgimi në Eurostat i raportit për Shqipërinë mbi Matjen e fuqisë blerëse;
3. Përgatitja dhe publikimi mujor i statistikave të Tregtisë së jashtme të mallrave, bazuar në të dhënat administrative; Përgatitja e dy botimeve, "Tregtia e jashtme, 2011-2015" dhe "Tregtia e jashtme sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, 2011-2015";
4. Kryerja e vrojtimit, përpunimi dhe publikimi i rezultateve mbi Statistikat tremujore të ndërmarrjeve;
5. Kryerja e vrojtimit, përpunimi dhe publikimi i rezultateve mbi Çmimet në industri dhe ndërtim;
6. Përpunimi dhe përgatitja e botimit, pjesë e Buletinit Statistikor të ndërmarrjeve mbi Lejet e ndërtimit të miratuara; mbi Transportin sipas llojeve, Aksidentet, Komunikacionin; mbi Turizmin (Lëvizjet e shtetasve);
7. Përgatitja e Bilancit të energjisë elektrike me periodicitet gjashtëmujor, bazuar në të dhënat administrative;
8. Kryerja e vrojtimit, përpunimi dhe publikimi i rezultateve paraprake dhe përfundimtare i Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve;
9. Bilanci i përgjithshëm i energjisë, vjetor, bazuar në të dhënat administrative;
10. Përditësimi i Regjistrave statistikorë të njësive ekonomike. Përgatitja e versionit të ngrirë të regjistrit të ndërmarrjeve, si dhe përgatitja e botimit "Regjistri statistikor i ndërmarrjeve, 2015";
11. Përditësimi i Klasifikimeve Ekonomike nga vrojtimit statistikore;
12. Plotësim i kërkesave nga përdorues të ndryshëm profesionalë dhe të zakonshëm;
13. Plotësim pyetësorë, detyrim ndaj institucioneve ndërkombëtare;
14. Kryerja e vrojtimit dyvjeçar mbi Kërkim-Zhvillimin;

Aktivite të reja të realizuara:

1. Hartimi, llogaritja dhe përgatitja për publikimi e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK);
2. Hartimi, llogaritja dhe publikimi i Indeksi i Çmimeve të Importit.

Drejtoria e Statistikave Sociale

Drejtoria e Statistikave Sociale është furnizuesi kryesor i statistikave që përshkruajnë aspektet demografike dhe sociale të popullsisë, siç janë statistikave vitale, migracioni, arsimit, punësimi, shëndeti, mbrojtja dhe përfshirja sociale, barazia gjinore dhe siguria. Këto statistika gjejnë një përdorim të gjerë që nga hartuesit e politikave për zhvillim dhe integrim, organizatave botërore që ofrojnë mbështetje të reformave në fushën sociale deri për përdorues individualë brenda dhe jashtë vendit, të cilët i përdorin për kërkime shkencore apo qëllime akademike.

Metodologjia e përdorur për nxjerrjen e treguesve socialë ka ndjekur standartet ndërkombëtare dhe synon një përafrim gjithnjë e më të madh me standartet e Eurostat.

Aktivitetet e vazhdueshme të realizuara:

Bazuar në planin e aktiviteteve për vitin 2016, si dhe në përputhje me PSZ 2012 – 2016, Drejtoria e Statistikave Sociale (DSS) ka vazhduar punën për realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

1. Llogaritja e popullsisë dhe strukturës për grup-moshë dhe qarqe për vitin 2015;
2. Llogaritja e statistikave vitale në bazë të skedave me karakteristikat demografike;
3. Llogaritja e treguesve të arsimit sipas niveleve të Klasifikimit Ndërkombëtar Standart të Arsimit – ISCED 2011;
4. Llogaritja e treguesve për institucionet arsimore publike e private, sipas zonave dhe niveleve të arsimit;
5. Llogaritja e treguesve të tregut të punës me periodicitet tremujor dhe vjetor bazuar në të dhënat e Anketës së vazhdueshme të Forcave të Punës (AFP) 2016;
6. Përgatitja e skedarëve me variablat e migracionit nga AFP për Sektorin e Statistikave të Popullsisë;
7. Përgatitja e tabelave bazuar në të dhënat e AFP për llogari të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare;
8. Llogaritja e treguesve mbi punësimin, papunësinë, pagat dhe ndihmën ekonomike me periodicitet tremujor dhe vjetor bazuar në të dhënat administrative;
9. Llogaritja e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të njësisive ekonomike familjare dhe tregues të tjerë të lidhur me to, bazuar në Anketën e vazhdueshme të Buxhetit të Familjes (ABF);

10. Përgatitja e skedarëve dhe tabelave të nevojshme për efekt të llogaritjes së PBB dhe përditësimit të IÇK për sektorët përkatës;
11. Përgatitja e publikimit “Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2016”;
12. Përdorimi i treguesve të projeksioneve të popullsisë për të ndihmuar në llogaritjen e popullsisë së Shqipërisë si metodë indirekte në llogaritjen e migracionit;
13. Përmirësime metodologjike dhe kryerja e vlerësimeve në kuadër të projektit: “Bashkëpunimi për partneritet me statistikave të Suedisë” lidhur me statistikave të gender, statistikave të krimeve, statistikave të kulturës dhe Anketën e Buxhetit të Familjeve;
14. Projekti “Matja dhe vlerësimi i krimit të organizuar në vendet perëndimore të Ballkanit” iniciuar në vitin 2016 nga UNODC, i cili synon të zhvillojë një kuadër statistikor dhe konceptual për matjen dhe vlerësimin e krimit të organizuar në vendet perëndimore të Ballkanit;
15. Plotësimi i pyetësorëve standartë të dërguar nga institucione ndërkombëtare dhe kërkesave të përdoruesve me të dhëna;
16. Hartimi i PSZ 2017-2021.

Aktivitetet e reja të realizuara:

1. Llogaritja e treguesve të rinj të statistikave demografike: jetëgjatësia në lindje sipas gjinisë, koeficienti bruto i lindshmërisë, koeficienti bruto i martesave, koeficienti bruto i vdekjeve dhe koeficienti i vdekshmërisë foshnjore dhe i fëmijëve.
2. Llogaritja e treguesve kryesorë të tregut të punës sipas qarqeve;
3. Llogaritja e treguesve të kulturës bazuar në të dhënat administrative;
4. Llogaritja e treguesve të krimeve bazuar në të dhënat administrative;
5. U krye Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, e cila siguron mbledhjen e informacionit mbi strukturën e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri;
6. U krye Vlerësimi Sektorial i Statistikave të Forcave të Punës me fokus të veçantë në parimet e koherencës, për të vlerësuar nivelin e përputhshmërisë së Statistikave të Tregut të Punës me rregulloren e Eurostat. Vlerësimi përfshinte përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, nivelin e kapaciteteve teknike të stafit, kuadrin institucional, cilësinë e procesit statistikor, dobishmërinë, përdorimin dhe aksesimin e rezultateve;
7. U miratua Lista Kombëtare e Profesioneve, ISCO 08, rishikuar Komisioni i Nomenklaturës;
8. U organizua takimi i punës me tematikë “Puna përgatitore e INSTAT për zbatimin e standardeve të reja ndërkombëtare të statistikave të punës-zënies, punësimit dhe nën-përdorimit të punës”. Në këtë kuadër, u realizua ngritja e një komiteti teknik pune për diskutimin e pyetësorit të projektit pilot mbi zbatimin e standardeve të reja ndërkombëtare të ILO;
9. U krye mbledhja e të dhënave nga vendet e Europës Juglindore për realizimin e publikimit “Femra dhe Meshkuj në rajon”, koordinuar nga UNWOMEN;
10. U krye realizimi i një dokumenti për metadat në lidhje me statistikave juridike, në templat-in ESMS për raportimin e të dhënave të cilësisë.

Burimet njerëzore dhe financiare

Sektori Juridik dhe Burimet njerëzore

Aktivitetet të realizuara për vitin 2016

Miratimi i strukturës së re organizative me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 126 datë 10.09.2015 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave” i ndryshuar, bëri që Sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore gjatë tremujorit të parë të vitit 2016 të fokusohet në finalizimin e procesit të ristrukturimit. Në bazë të Strukturës së re organizative, Instituti i Statistikave përbëhet nga 8 drejtori dhe Sektori i Auditit të Brendshëm.

Për rregullimin e këtij detyrimi ligjor është punuar me kujdes nën udhëzimin e vazhdueshëm të DAP-it për të gjitha pozicionet e strukturës dhe plotësimin e tyre me hartimin e mbi 100 shkresave të transferimit.

Në fund të vitit 2016, INSTAT kishte 199 punonjës në total ndaj 216 pozicioneve të strukturës. Ndër ta, 161 janë punonjës civil nga të cilët 5 në periudhë prove dhe 156 punonjës me status të nëpunësit civil. Ndërsa punonjësit me kontratë në fund të 2016 rezultojnë 17.

Vendet vakante në shërbimin civil, në fund të vitit 2016, rezultojnë 38. Shumë prej tyre janë pozicione të shpallura nga DAP por procesi i rekrutimit akoma nuk kishte përfunduar në fund të dhjetorit 2016. Sipas ligjit të ri për nëpunësin civil, procedurat e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve civilë për INSTAT kryhen nga Departamenti i Administratës Publike por procesi i deklarimit të vendeve vakante si rezultat i lirimive, daljeve në pension etj bëhet nga Sektori Juridik dhe Burimet njerëzore në fillim të vitit në aplikacionet përkatëse HRMS.

Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, stafi i INSTAT-it përbëhet kryesisht nga gjinia femërore. Megjithë ndryshimet që solli struktura organizative e vitit 2015, përqindja e vendit që zenë femrat është 72 % kundrejt meshkujve me 28 %.

Figura 4: Përqindja e punonjësve të INSTAT sipas gjinisë






Figura 5: Punonjësit e INSTAT sipas grupmoshës për vitin 2016





Burimet Financiare

INSTAT është institucionin publik qendror, në varësi të Kryeministrit. Burimet e financimit për kryerjen e aktivitete statistikore dhe atyre mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Gjatë vitit 2016, drejtorja ka punuar për mbylljen e vitit ushtrimor 2015 dhe përgatitjen e Bilancit të vitit 2015 për Aparatin Qëndror INSTAT.


Në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të institucionit, u përgatit projekt-buxheti afatmesëm 2017-2019, në të dyja fazat të parashikuara nga aktet nënligjore duke i dorëzuar brenda afateve të kërkuara.

Për vitin 2016 janë shpenzuar rreth 368 milion lekë.


Tabela 5: Shpenzimet, 2011-2016

SHPENZIMET	FAKT					
	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Paga + kontribut	187,977.00	275,973.00	231,327.80	278,819.00	280,366.00	274,469
Mallra dhe shërbime të tjera	166,301.00	118,128.00	59,070.50	60,091.00	57,574.80	58,318
Totali operative	354,278.00	394,101.00	290,398.30	338,910.00	337,940.80	332,786.59
Investime	333,069.00	22,215.00	2,997.20	6,928.00	6,401	11,599
TOTALI BUXHETI	687,347.00	416,316.00	293,395.50	345,838.00	344,341.80	344,385.60
Paga + kontribut	13,428.00	12,646.00	12,941.70	14,055.00	6,518.00	6,538.98
Mallra dhe shërbime të tjera	421.00	645.00	102.90	44.00	7,954.00	10,253.78
Totali operative	13,849.00	13,291.00	13,044.60	14,099.00	14,472.00	16,792.76
Investime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
TOTALI nga të ardhurat	13,849.00	13,291.00	13,044.60	14,099.00	14,472.00	16,792.76
Paga + kontribut	187.00	336.00	1,146.00	527.00	869.00	3,515.40
Mallra dhe shërbime të tjera	1,795.00	4,710.00	11,610.00	4,949.00	4,620.00	950.30
Totali operative	1,982.00	5,046.00	12,756.00	5,476.00	5,489.00	4,465.70
Investime			328.00			
Te ardhura jashtë limiti	1,982.00	5,046.00	13,084.00	5,476.00	5,489.00	4,465.70
Paga + kontribut	25,185.00	61,106.00	8,514.00	4,558.00	723.00	1,429.50
Mallra dhe shërbime të tjera	681,471.00	312,073.00	61,143.00	98,905.00	15,883.00	606.30
Totali operative	706,656.00	373,179.00	69,657.00	103,463.00	16,606.00	2,035.80
Investime	822.00	14,266.00	400.00		2,769.00	
Te ardhura donator	707,478.00	387,445.00	70,057.00	103,463.00	19,375.00	2,035.80
Paga + kontribut	226,777.00	350,061.00	253,929.50	297,959.00	288,476.00	285,952.75
Mallra dhe shërbime të tjera	849,988.00	435,556.00	131,926.40	163,989.00	86,031.80	70,128.10
Totali operative	1,076,765.00	785,617.00	385,855.90	461,948.00	374,507.80	356,080.85
Investime	333,891.00	36,481.00	3,725.20	6,928.00	9,170.00	11,599.01
TOTALI	1,410,656.00	822,098.00	389,581.10	468,876.00	383,677.80	367,679.86

Siç shihet nga grafiku i mëposhtëm, volumin kryesor të shpenzimeve në vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe ajo e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme. Ndërkohë, për vitin 2011 dhe 2012 ka patur një rritje në mallra dhe investime për shkak të zbatimit të Censurit të Popullsisë e Banesave 2011 si dhe Rregjistrimit të Përgjithshëm të Bujqësisë.

Figura 6: Shpërndarja e shpenzimeve operative dhe investimeve në vite

Për shkak të natyrës së punës që ka institucioni, pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë pagat e personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të tyre.

Figura 7: Shpenzimet 2016

Institutit të Statistikave për vitin ushtrimor 2016 i janë akorduar nga buxheti i shtetit 373.047 mijë lekë. Këto fonde INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistike”.

Integrimi Evropian dhe Koordinimi i Projekteve

Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve dhe Publikimeve, koordinon punën e të gjithë strukturave të INSTAT, për fushat e përqendruara në elementët kryesorë të acquis communautaire, programon zbatimin teknik dhe monitorimin e fondeve IPA, koordinon punën me donatorët për projektet/programet e BE-së dhe ndihmës së huaj për të cilat INSTAT është përfituese. Sipas VKM Nr. 106 datë 10.09.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Statistikës”, Drejtorisë së Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve dhe Publikimeve, ju shtua Sektori i Monitorimit dhe Zbatimit të Programit Statistikor Zyrtar. Në funksion të këtij ndryshimi drejtoria koordinon punën për grumbullimin dhe konsolidimin e materialeve nga Drejtoritë teknike të INSTAT dhe Agjencitë Statistike dhe përgatit raportet e monitorimit të zbatimit të objektivave të PSZ. Koordinon punën mbi raportimin dhe zbatimin e Programit Statistikor Zyrtar, duke nxitur rritjen e ndërgjegjësimit të Agjencive Statistike Zyrtare dhe institucioneve shtetërore për rolin dhe përgjegjësinë e INSTAT si koordinator i sistemit kombëtar statistikor dhe si rrjedhojë për detyrimet e INSTAT për ndjekjen dhe raportimin sipas ligjit të performancës së sistemit kombëtar statistikor.

Projektet në zbatim për vitin 2016 janë si në vijim:

- 1. IPA Shumëpërfituese 2014**, ka filluar zbatimin në 1 Nëntor 2015 dhe do të përfundojë 30 Shtator 2017. Ky program zbatohet nga kompania e konsulencës GOPA Consultants.
Mbështetja nga programi IPA MB 2014, përfshin 20 projekte pilote për fushat statistikore, investimin për rritjen e kapaciteteve të personelit të INSTAT dhe të agjencive statistikore zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës së sistemit evropian të statistikave (ESS) për çdo fushë statistikore, trajnimeve afatshkurtra dhe trajnimeve afat-gjata në formën e stazheve të punës pranë zyrave të statistikave të vendeve anëtare dhe Eurostat.
- 2. Projekti i financuar nga Sida: Bashkëpunimi statistikor ndërmjet Statistikave të Suedisë(SCB) dhe INSTAT faza IV (Tetor 2014 – Dhjetor 2017).** Gjatë vitit 2016, është në zbatim faza e katërt e bashkëpunimit midis SCB dhe INSTAT, duke siguruar kështu një ndihmë të konsiderueshme në përmirësimin e metodologjisë statistikore, me përmirësimin e infrastrukturës së TIK, përmirësimin e statistikave ekonomike, mjedisit,

bujqësisë, metodologjisë statistikore, përmirësimin e statistikave sociale, komunikimin e statistikave, rritjen e transparencës së institucionit dhe aksesit të përdoruesve në shërbimet dhe produktet statistikore, etj.

Kjo fazë e asistencës përfshin periudhën prej muajit tetor të vitit 2014 deri në dhjetor të 2017.

- 3. “Fondi Direkt për Zhvillimin e infrastrukturës së IT së INSTAT dhe krijimi i një qendre trajnimi”** Instituti i Statistikave mbështetur nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SIDA-s, ka filluar projektin në muajin Korrik 2015 dhe do zgjasë deri më 30 qershor 2017. Qëllimi i projektit është të modernizojë platformën ekzistuese të infrastrukturës dhe ngritjen e një qendre trajnimi brenda ambienteve të INSTAT-i dhe pajisjen e anketuesve me pajisje të lëvizshme për intervista në terren.

Programi rajonal i Statistikave të Suedisë (SCB) - krahas programit kombëtar me institucionet partnerë përkatës në Ballkanin përfundimor, me mbështetjen financiare të Sida-s, statistikave Suedeze (SCB) kanë gjithashtu programe të bashkëpunimit rajonal, aktualisht për periudhën 2013-2016, ku përfitues është edhe Shqipëria.

- 4. IPA 2013 Kombëtare – “Mbështetje për Sistemin Statistikor Shqiptar”.** Në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, (VKM nr. 707, datë 21.08.2013 dhe VKM nr. 541 datë 18.06.2015) INSTAT ka filluar zbatimin e Projektit IPA 2013. Ky projekt zbatohet nga një Consortium i cili përfshin dy kompani Computas IT Romania and IN2. Qëllimi i kësaj kontrate është rritja e kapaciteteve në Sistemin Statistikor Shqiptar, veçanërisht në INSTAT, për vijimësinë e proceseve statistikore dhe zhvillimin e një arkitekture të ridizenjuar të IT-së bazuar në konceptin e dataëarehouse duke bërë të mundur prodhimin efikas dhe efektiv, analizimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare duke përmbushur kërkesat e acquis mbi statistikat dhe duke ndjekur praktikatat më të mira si janë implementuar në ESS.

5. Projekti SECO

Prej viti 2014 SECO mbështet INSTAT nëpërmjet FMN-së në përmirësimin e statistikave të qeverisë. Pas përfundimit të fazes së të tij në vitin 2016, u vendos që ky projekt të vijojë edhe për 3 vite të tjera duke u fokusuar në;

- Ndërtimin e treguesve të EDP-së
- Ndërtimin e Inventarin të EDP-së

- Përmirësimin e llogarive të GFS
- Arritje e ndërtimit të Statistikave të Qeverisë tremujore

Aktivitetet kryesore

Gjatë vitit 2016 në kuadër të marrëdhënieve me Jashtë, INSTAT ka pritur disa takime të nivelit të lartë nga Eurostat si dhe ka zhvilluar disa takime në kuadër të zbatimit të axhendës së Integrimit Evropian. Gjithashtu ka patur edhe takime te nivelit të lartë në kuadër të zbatimit të projekteve.

- Gjatë datave 5-7 Shtator, INSTAT priti misionin e përvitshëm nga EUROSTAT, ku morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Marrëdhënieve me Jashtë të Eurostat Z. Pieter Everaers dhe Desk officer për Shqipërinë Z. Torbioern Carlquits. Gjatë këtyre ditëve u realizuan një sërë takimesh mes stafit të INSTAT, Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë, Takim me Përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit dhe Delegacionin Evropian.
- Gjatë datave 14 - 17 Nëntor, INSTAT priti misionin nga EUROSTAT, me përfaqësuesin e Eurostat për Shqipërinë Z. Torbioern Carlquist. Gjatë këtyre ditëve u realizuan një sërë takimesh mes Menaxhimit të lartë dhe stafit të INSTAT për tu përditësuar me të rejat më të fundit.
- Organizimin dhe pjesëmarrjen në grupet ndërinstitucionale të punës për kapitullin 18, ku INSTAT është lider si dhe në kapitujt ku INSTAT kontribuon me statistika
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Komitetin e shtatë të Stabilizim-Asocimit organizuar në Tiranë më datë 9 Qershor.
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Komitetin e Monitorimit IPA mbajtur me 18 Janar 2017 në Tiranë
- Pjesëmarrja dhe kontributi në takimit e tetë të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet” i cili u zhvillua në Tiranë në datën 23 – 24 janar 2017.
- Në kuadër të projekti financiar nga Sida: Bashkëpunimi statistikor ndërmjet Statistikave të Suedisë(SCB) dhe INSTAT faza IV (Tetor 2014 – Dhjetor 2017). në datën 26 Tetor 2016 u zhvillua Steering Committee vjetor, ku përfaqësuesit e çdo komponenti prezantuan arritjet dhe rezultatet për çdo komponent.

Aktivitetet në kuadër të PSZ - së

- Hartimin e draftit të PSZ-së dhe më pas finalizimin e këtij dokumenti
- Marrja e inpueteve nga drejtoritë teknike për aktivitetet statistikore që do të mbulojnë PSZ-në dhe finalizimi në dokumentin përfundimtar të tij.


Aktivitetet e pa realizuara

- Projekti IPA 2013 “Mbështetje për Sistemin Statistikor Shqiptar” ka hasur disa problematika gjatë zbatimit të tij. Mungesa e ekspertëve kryesorë të dy prej komponentëve ka shkaktuar mos realizim të disa prej aktiviteteve dhe shtyrje të disa aktiviteteve.
- Projekti “Fondi Direkt për Zhvillimin e infrastrukturës së IT së INSTAT dhe krijimi i një qendre trajnimi” ka patur disa vonesa në zbatimin e tij. Kjo për shkak të lidhjes së këtij projekti me Projektin IPA 2013.


Ngritje kapacitetesh

Gjatë vitit 2016 në INSTAT kanë qenë në zbatim projekte të ndryshme. Sektori i Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve ka ndjekur dhe kontribuar në mbështetjen e sektorëve teknikë të INSTAT gjatë zbatimit të projekteve. INSTAT është i orientuar ndaj punonjësve dhe vazhdimisht tenton të ngrejë kapacitetet e stafit. Ngritje kapacitetesh për punonjësit e INSTAT është kategorizuar në këto nëndarje:

- Pjesëmarrje mbledhje- workshope
- Pjesëmarrje study visit
- Trajnimet afatshkurtra
- Trajnimet afatgjata

Figura 8: Ngritja e Kapaciteteve sipas viteve dhe gjinisë

Gjatë vitit 2016 ka patur një rritje të numrit të kapaciteteve, 218 punonjës të trajnuar ndërsa gjatë vitit 2015 janë trajnuar rreth 190 punonjës.

Figura 9: Ngritja e Kapaciteteve sipas llojit të aktivitetit

Grupet e punës, seminare, konferenca, workshope (pjesëmarrje mbledhje - workshope)

Në kuadër të projekteve për vitin 2016 janë zhvilluar 169 aktivitete ku 80 persona kanë ndjekur zhvillimet më të fundit në fushën e statistikave. Grupet e punës, seminarët, konferencat, workshopet për vitin 2015 ka qënë 130.

Kurset e trajnimit (Trajnimet afatshkurtra)

Në kuadër të projekteve për vitin 2016 janë zhvilluar 34 kurse trajnimi afatshkurtra, ku janë trajnuar 29 persona. Kurse të cilat organizohen në kuadër të Programit Evropian për Trajnim

Statistikor dhe kurse trajnimi të organizuara nga GOPA. Trajnime afatshkurtra për vitin 2015 ka qënë 24.

Trajnimet Afatgjata


Nga programi IPA 2014, gjatë 2016 janë kryer 11 trajnime, 5 trajnime afatgjata për periudhën Janar - Qershor 2016 dhe 6 trajnime afatgjata për periudhën Shtator - Dhjetor 2016. Trajnime afatgjatapër për vitin 2015 ka qënë 12.

Pjesëmarrje Vizita studimore

Në kuadër të projekteve për vitin 2016 janë zhvilluar 4 pjesëmarrje në vizitat studimore, kanë ndjekur zhvillimet më të fundit në fushën e statistikave evropiane. Pjesëmarrja në vizita studimore për vitin 2015 ka qënë 24.


Stafi i INSTAT është trajnuar të paktën një herë rreth 54 %, gjatë vitit 2016, mesatarisht një punonjës ka marrë rreth 2 trajnime gjatë vitit 2016.

Figura 10: Ngritja e Kapaciteteve sipas herëve gjatë 2016




Nga grafiku i mësipërm vërehet re se rreth 41 punonjës kanë marrë pjesë në një aktivitet për ngritje kapacitetesh gjatë vitit 2016, 36 punonjës kanë marrë pjesë në dy aktivitete për ngritje kapacitetesh gjatë vitit 2016. Në grafikun e mëposhtëm jepet ngritja e kapaciteteve sipas viteve dhe pozicioneve të punës. Struktura organizative e INSTAT sipas pozicioneve të punës ndahet nëpër këto kategori :

- Drejtor Drejtorie
- Përgjegjës sektori
- Specialist

Figura 11: Ngritja e Kapaciteteve sipas viteve dhe pozicioneve të punës

Gjatë vitit 2016, specialistët e INSTAT kanë marrë pjesë në 118 aktivitete të ndryshme jashtë vëndit ku kanë ndjekur zhvillimet më të fundit në fushën e statistikave.


Figura 12: Ngritja e Kapaciteteve fondeve të financimit

Gjatë vitit 2016, stafi i INSTAT kanë marrë pjesë në 177 aktivitete të ndryshme jashtë vëndit të financuara nga IPA Shumë Përfituese 2014, financim nga buxheti i INSTAT , Projekti Sida. Në “të tjera” përfshihen financimet nga mbështetja e donatorëve UNECE, EFTA, Agjensitë e UN, FMN, SESRIC.

Publikimet - Databaza e kërkesave të përdoruesve


Databaze i përdoruesve u krijua për herë të parë në vitin 2009. Mbi bazën e këtij databaze INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të këtij databaze, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme në vitin 2014 dhe vazhdon të ketë rritje jo aq të theksuar edhe në vitin 2015. Gjatë 2016 vihet re një rënie e numrit të kërkesave nga përdoruesit në 509 kërkesa nga 729 kërkesa që ka patur në vitin 2016 (220 kërkesa më pak). (shih grafikun)

Figura 13: Numri i kërkesave të përdoruesve 2012-2016



Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve në vitin 2016 është ulur duke arritur shifrën 509 kërkesa nga 729 kërkesa në vitin 2015. Pra, në ndryshim nga viti 2015 ku rritja e kërkesave ndaj 2014 ishte me 16,27 % në vitin 2016 kemi një rënie të kërkesave me 30,28 % kundrejt vitit 2015. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave ekonomike me 53 % duke u pasuar nga kërkesat e statistikave sociale 17,5 %, të dhëna të 2 a më shumë fushave statistikore 13,6 %, statistikave mbi llogaritë kombëtare me 1,6 % etj.

Figura 14: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore.



Numrin më të madh të kërkesave të plotësuara në vitin 2016 e zënë statistikat ekonomike me 270 kërkesa, ku kryesojnë statistikat e Çmimeve me 147 kërkesa të plotësuara, pasuar nga statistikat e tregtisë së jashtme me 53 kërkesa si dhe statistikat ekonomike pranë ndërmarrjeve me 37 kërkesa, etj. Një pasqyrë më të hollësishme mund ta konsultoni në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore

Kërkesat e përdoruesve	2015		2016	
	Numër	Përqindje	Numër	Përqindje
Stat. të Çmimeve	173	23,7	147	28,8
Stat. të Tregtisë së Jashtme	71	9,7	53	10,4
Stat. të Asn e prodhimi	55	7,5	8	1,5
Statistika të Turizmit e Transportit	52	7,1	30	5,8
Stat. popullsisë	80	11	32	6,2
Stat. të ardhurave dhe të konsumit në familje	39	5,3	9	1,7
Stat. të tregut të punës	55	7,5	24	4,7
Stat. të Regjistrimit të Ndërmarrjeve	44	6	29	5,7
Stat. Llogaritë Kombëtare gjithsej	55	7,5	8	1,6
Stat. të Bujqësisë gjithsej	43	5,9	10	2,0
Kërkesa të dy a me shumë fushave statistikore			159	31,2
Gjithsej	729	100	509	100

Tabela 9: Kërkesat e detajuara të përdoruesve sipas temave, 2016

Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave
Çmimet	147
Bujqësia	10
Tregtia e jashme	53
Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore	69
ASN	8
Ndërmarrjet	29
Llogaritë kombëtare	8
Arsimi / lindjet-vdekjet / shkaqet e vdekjeve/ martesat-divorcet	9
Ndërtimi	3
Popullsia	32
Emigracioni	3
Punësimi / pagat	24
Turizmi / transporti / telekomunikacioni	30
Pyetësor të ndryshëm	7
Konsumi i familjeve / niveli jeteses	9
Aksidentet / krimet	3
Shendeti, Sigurimet Shoqerore dhe Mbrojtja sociale / ndihma ekonomike	5
Feja dhe minoritetet	4
Kode / metodologji / publikime	8
Të tjera / të ndryshme	48
Totali	509

Publikimet – Të dhënat e faqes


Statistikat e website

Gjatë vitit 2016 në webin e INSTAT ka patur 214.293 sesione² nga 210.437 që ishin në vitin 2015. Sesionet gjatë vitit 2016, janë rritur me 1,83 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Totali i përdoruesve³ gjatë vitit 2015 është 113.085 nga 104.995 që ishte në vitin 2015, duke përsuar një rritje prej 7,71 %.

Për vitin 2016 faqja web e INSTAT është shikuar⁴ 912,074 nga 997.548 në vitin 2015 me një rënie prej 8,57 %.

Një risi tjetër e cila shërben për të shpërndarë produktin statistikor është dhe numri i përdoruesve të telefonave mobile si dhe tablet në faqen e INSTAT. Siç shihet nga grafiku numri i përdoruesve mobile ka përsuar një rritje çka duhet të synojë që produktet e reja të INSTAT duhet të fokusohen në versione mobile si dhe objektiv i këtij viti është ndërtimi i versionit mobile të faqes së INSTAT. Grafiku më poshtë e ilustron.

Figura 15: Numri i sesioneve sipas llojit të pajisjes



²Numri total i sesioneve brenda datave të kërkuara (date range – datat që ndodhen në mes të datës së fillimit dhe mbarimit). Sesion është periudha kohore që një përdorues është i angazhuar në mënyrë aktive në faqes, app, etj. Të gjitha të dhënat e përdorimit janë të lidhur me një seancë.

³Numri total i përdoruesve që kanë pasur të paktën një seancë brenda datave të kërkuara (data range), këtu përfshihen dy lloj përdoruesish, të rinjtë dhe ato që rikthehen.

⁴Pageviews - Shikimi i faqeve, është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikimet

Gjatë vitit 2016, 10 vendet kryesore që kanë vizituar faqen zyrtare të INSTAT janë Shqipëria, India, SHBA, Kosovë, Itali, Angli, Gjermani, Greqi, Maqedoni dhe Polonia. Shqipëria kryeson renditjen me 146.489, një ulje prej 3 % krahasuar me një vit më parë ku numri i sesioneve ishte 151.686 sesione. Në vend të dytë është India me 11.019 sesione, një rritje më shumë se 8 herë krahasuar me vitin 2015, ku numri i sesioneve ishte vetëm 1369. Në vend të tretë është SHBA me 8.806 sesione nga 6.510 në vitin 2015, me një rritje prej 27 %. Kosova renditet e katërta në rradhë me 6.285 sesione nga 6.510 sesione në vitin 2015, duke pësuar një ulje prej 3 %. Një rritje të dukshme të numrit të sesioneve (49 %) vihet re nga Anglia me një numër sesionesh 4.585 gjatë 2016 krahasuar me 3079 gjatë vitit 2015. Vendin e 9 e mban Maqedonia me 1.928 sesione në 2016 nga 2.290 në 2014, me një rënie prej 16 % e ndjekur nga Polonia në vend të 10 me 1.880 sesione nga 1.752 në vitin 2015, me rritje prej 7 %. Mund të konkludojmë se vendet si India, Anglia, SHBA, Polonia dhe Greqia shënojnë një rritje për sa i përket numrit të sesioneve gjatë vitit 2016 krahasuar me një periudhë më parë. Ndërkohë Italia, Shqipëria, Kosova, Gjermania dhe Maqedonia shënojnë një ulje të numrit të sesioneve për të njëjtën periudhë referencë.

Në aplikacionin INSTATGIS.GOV.AL gjatë vitit 2016 ka patur 20.936 faqe të shikuara (pageviews) nga 29.514 që ishte një vit më parë. Në vitin 2016, numri i faqeve të shikuara ka pësuar një rënie prej 41 % krahasuar me 2015.

Kontaktet e institucionit



INSTAT - Instituti i Statistikave

Bul."Zhan D'Ark", Nr .3 Tiranë, Shqipëri

Tel+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356

Fax+(355) 4 2228300

www.instat.gov.al

info@instat.gov.al